



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bilanci i Energjisë TM2 2018



Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë si dhe importin dhe eksportin e enërgjentëve tjerë. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore për tremujorin e dytë të vitit 2018.

Burimet e të dhënave të shfrytëzuara janë: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike KESCO dhe Statistikat e Tregtisë së Jashtme.

Duke u bazuar në kërkesa të vazhdueshme nga shfrytëzues të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm dhe në bazë të indikatorëve që publikon EUROSTAT-i për statistika energjetike, kemi prezantuar të dhëna me interes.

Qëllimi i publikimit është që të vejë në dukje tendencën e zhvillimit të këtij sektori.

Publikimi do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Në mënyre të veçantë falënderojmë Korporatën Energjetike të Kosovës dhe Kompanitë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike pa bashkëpunimin e të cilave nuk do të ishte i mundur ky publikim.

Publikimin e përgatitën:

Ilir T.Berisha – Drejtor i Departamentit
Ismail Sahiti – Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike
Hysni Elshani – Shef i sektorit të statistikave Ekonomike
Bekim Bojku – Zyrtar
Sulltane Gashi – Zyrtare
Violeta Syla – Zyrtare
Qendresa Shala – Zyrtare
Ahmet Cakolli – Zyrtar për dizajnim.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni ne adresën elektronike:
(E-mail: economic@rks-gov.net)

Gusht, 2018

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Simbolet dhe shkurtesat

TM 1 – Tremujori i parë

TM 2 – Tremujori i dytë

TM 3 – Tremujori i tretë

TM 4 – Tremujori i katërt

DIS – Shpërndarje

GWh – Njësia matëse për energjinë elektrike (Giga wat orë energji).

MWh – Njësia matëse për energjinë elektrike (Mega wat orë energji) (1GWh=1000MWh).

Çelësi i simboleve

- Nuk aplikohet

: Nuk ka të dhëna.

Përmbajtja

Faqe

Prodhimi i thëngjillit për tremujorin e dytë të vitit 2018.....	4
Prodhimi bruto i energjisë elektrike në TC & HC për tremujorin e dytë të vitit 2018.....	4
Importi dhe eksporti i energjisë elektrike për tremujorin e dytë të vitit 2018	4
Konsumatorët final për tremujorin e dytë të vitit 2018.....	4
Importi dhe eksporti i energjentëve për tremujorin e dytë të vitit 2018	4
Shpjegimet metodologjike dhe përkufizime.....	5
1 Prodhimi dhe konsumi i thëngjillit, prodhimi i energjisë elektrike në termocentrale dhe hidrocentrale, importi dhe eksporti i energjisë elektrike	7
2 Importi dhe eksporti i derivateve të naftës dhe thëngjillit	9
3 Konsumatorët final (të fundit)	11

Prodhimi i thëngjillit për tremujorin e dytë të vitit 2018

Në tremujorin e dytë të vitit 2018, prodhimi i thëngjillit është 1 636.1 mijë ton.

Prodhimi bruto i energjisë elektrike në TC & HC për tremujorin e dytë të vitit 2018

Në tremujorin e dytë të vitit 2018 sasia bruto e energjisë elektrike e prodhuar ne Termocentrale është 1 402.5 GWh, kurse në hidrocentrale është rreth 118.1 GWh.

Importi dhe eksporti i energjisë elektrike për tremujorin e dytë të vitit 2018

Në tremujorin e dytë të vitit 2018, Kosova ka importuar 23.0 GWh energji elektrike.

Në këtë tremujorë (TM2 2018) Kosova ka eksportuar 344.2 GWh energji elektrike.

Konsumatorët final për tremujorin e dytë të vitit 2018

Në tremujorin e dytë të vitit 2018, sasia e energjisë elektrike për konsum ishte 879.8 GWh energji elektrike. Në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM2 2017), sasia e energjisë elektrike të konsumuar është ulur për 6.7%.

(Për të parë shpërndarjen e energjisë elektrike sipas konsumatorëve final në përqindje shiko graf.1) .

Importi dhe eksporti i energjentëve për tremujorin e dytë të vitit 2018

Për të parë ecurinë e importit dhe eksportit të enërgjentëve për periudhën e dytë të vitit 2018 shihni tabelën 2a dhe 2b.

Shpjegimet metodologjike dhe përkufizime

¹Energji Elektrike – Nënkupton formën e energjisë e cila transportohet përmes përçuesve metalik.

Energjia – Do të thotë çdo formë e prodhuar ose e fituar e energjisë (energjia elektrike, ngrohja ose gazi natyror) me qëllim të furnizimit ose shitjes.

Enërgjentë – Lëndët djegëse të cilat gjatë djegëjes lirojnë energji me një fjalë quhen energjentë.

Ndërmarrja e energjisë – Nënkupton ndërmarrjen e energjisë e cila ushtron një ose më shumë nga aktivitetet energjetike në vijim: prodhimin, transformimin, bartjen, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin ose deponimin e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror në bazë të një licence të lëshuar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë apo pa licencë nëse licenca në fjalë nuk kërkohet.

Prodhimi i thëngjillit – Paraqet sasinë e thëngjillit që nxirret nga minierat.

Prodhimi i energjisë elektrike - Paraqet sasinë e energjisë që prodhohet në Termocentrale dhe Hidrocentrale.

Prodhimi i Energjisë – Nënkupton prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes ose ndonjë forme tjetër të energjisë.

Bruto Prodhimi i Energjisë – Paraqet gjithë sasinë e prodhimit të Energjisë Elektrike në Termocentrale apo Hidrocentrale.

Neto Prodhimi i Energjisë – Paraqet sasinë e Energjisë Elektrike në prag.

Importi i energjisë elektrike – Paraqet sasinë e energjisë elektrike që blihet jashtë kufijve të shtetit.

Eksporti i energjisë elektrike – Paraqet sasinë e energjisë që shitet jashtë kufijve të shtetit.

Këmbimet e energjisë elektrike – Paraqesin sasinë e energjisë elektrike e cila këmbehet me energji jashtë vendit.

Humbjet e energjisë elektrike – Paraqesin atë sasi të energjisë elektrike e cila humbet në transmision dhe shpërndarje.

Konsumator – do të thotë konsumatori për blerje me shumicë ose konsumatori i fundit i energjisë.

Konsumatorët e privilegjuar (220 - 110kV) – janë konsumatorët e mëdhenj (0.4 KV) që ushtrojnë statusin e konsumatorit të privilegjuar.

Shpërndarja – do të thotë transporti i energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror me anë të linjave të tensionit të lartë, të mesëm ose tubacioneve me presion të mesëm ose të ulët me qëllim të dërgimit tek konsumatorët, por duke mos përfshirë furnizimin.

¹ Shpjegimet metodologjike janë marrë nga LIGJI Nr. 05/L-081 PËR ENERGINË.

²(2701) Qymyr – briket, formë vezake dhe lëndë djegëse të ngjashme të forta të prodhuara prej qymyri.

(2702) Linjit – nëse është apo jo i aglomeruar, duke përjashtuar qelibarin e zi.

(2703) Torfe – (duke përfshirë mbeturinat e tij), nëse është apo jo i aglomeruar.

(2704) Koks dhe gjysmë koks prej qymyrit, linjiti apo prej torfe. Nëse është apo jo i aglomeruar ; karbon i konvertuar:

(2705) Qymyr gaz, gaz ujë, gaz prodhues, gaz i dobët dhe gaze të ngjashme (EXCL. gazet e naftës dhe hidrokarbure tjera të gazta)

(2706) Katran i distiluar nga qymyri, nga linjiti apo nga torfa, dhe katran tjetër, nëse janë apo jo të dehidratuara apo pjesërisht të distiluar.

(2707) Vajra dhe produkte të tjera të distilimit në temperature të larta të katranit të qymyrit; produkte të ngjashme në të cilat pesha e përbërësve aromatik e tejkalon ato te atyre jo aromatike.

(2708) Terpentinë dhe koks terpentinë, fituar nga katrani i qymyrit apo prej katranëve të tjera minerale.

(2709) Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, bruto.

(2710) Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndrysho nga bruto; preparate të paspecifikuara dhe te pa përfshira diku tjetër, qe përmbajnë ndaj peshës 70 % apo më shumë vajra nafte apo vajra të fituara nga mineralet bituminoze. këto vajra duhet të jenë përbërësit bazë të preparatit.

(2711) Gazet e naftës dhe hidrokarbure tjera gazoil.

(2712) Xhelatinë nafte; dyllë parafine, dyllë mikrokristalin prej naftës, dyllë i lëngshëm, ozokerit, dyllë linjiti, dyllë torfe, dyllë tjetër të mineraleve, dhe produkte të ngjashme të fituar nga sinteza apo nga procese të tjera, nëse janë apo nuk janë të ngjyrosura.

(2713) Kokos nafte, bitum nafte dhe mbetje të tjera të vajrave të fituar prej mineraleve bituminoze.

(2714) Bitum dhe asfalt natyral; bituminoze ose vaj-tar shist argjilor dhe rëre, asfalt dhe gurë asfalti

(2715) Mastikë bituminoze të mbështetura dhe përzierjet tjera bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, bitum mbi natyrore, në bitum nafte ose në katranit mineral.

² Nomenklatura e mallrave dhe tarifave doganore.

1 Prodhimi dhe konsumi i thëngjillit, prodhimi i energjisë elektrike në termocentrale dhe hidrocentrale, importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Tab 1. Prodhimi i thëngjillit, prodhimi i energjisë elektrike në termocentrale dhe hidrocentrale, importi dhe eksporti i energjisë elektrike nga viti 2002- 2017

Periudha	Prodhimi i Thëngjillit mijë Tonë	Prodhimi bruto i energjisë elektrike ne TC në GWh	Prodhimi i energjisë në hidrocentrale GWh	Konsumi GWh (janë përfshirë edhe kons 220 -110kV)	Importi i energjisë GWh	Eksporti i Energjisë GWh
2002	5,527.9	3,151.7	:	1,950.4	816.1	648.2
2003	6,465.9	3,221.1	:	2,041.1	637.3	277.6
2004	5,658.3	3,481.1	:	2,139.3	650.7	194.7
2005	6,391.1	3,999.5	:	2,109.4	490.7	225.8
2006	6,532.4	3,970.5	:	2,154.9	537.9	253.3
2007	6,715.4	4,309.5	93.2	2,391.6	623.3	360.0
2008	7,842.0	4,505.8	75.7	2,941.0	647.6	235.0
2009	7,870.7	5,260.0	88.7	3,200.7	767.5	113.9
2010	7,958.1	5,481.0	115.5	3,480.3	816.6	350.6
2011	8,212.1	5,696.4	75.4	3,684.9	816.2	371.2
2012	8,028.4	5,847.2	65.0	3,611.6	625.1	472.8
2013	8,219.4	6,248.3	136.7	3,705.6	521.7	856.9
2014	7,204.2	5,324.0	151.4	3,772.0	875.3	474.8
2015	8,241.0	5,978.7	141.6	3,971.8	684.3	552.5
2016	8,800.8	6,248.8	234.6	3,595.3	458.8	1,064.2
2017	7,574.7	5,725.9	180.2	4,107.8	742.0	885.7

Tab 1a. Prodhimi i thëngjillit, prodhimi i energjisë elektrike në termocentrale dhe hidrocentrale, importi dhe eksporti i energjisë elektrike nga viti TM1 2012 – TM2 2018

Periudha	Prodhimi i Thëngjillit mjë Tonë	Prodhimi bruto i energjisë elektrike ne TC në GWh	Prodhimi i energjisë në hidrocentrale GWh	Konsumi GWh (janë perfshirë edhe kons 220 - 110kV)	Importi i energjisë GWh	Eksporti i Energjisë GWh
TM1-2012	2,222.1	1,737.4	12.4	1,033.5	217.3	53.7
TM2-2012	1,920.6	1,338.0	19.4	830.3	111.2	167.1
TM3-2012	1,700.5	1,134.7	13.7	825.8	154.7	90.1
TM4-2012	2,185.2	1,637.1	19.5	922.0	141.8	161.9
TM1-2013	1,964.8	1,713.9	16.4	1,006.8	229.7	100.4
TM2-2013	1,970.0	1,674.2	44.3	857.7	2.1	393.1
TM3-2013	2,116.8	1,319.0	50.7	871.8	142.5	221.3
TM4-2013	2,167.9	1,541.2	25.3	969.4	147.5	142.1
TM1-2014	2,143.7	1,795.7	19.6	958.2	167.2	243.1
TM2-2014	1,638.9	1,306.3	56.5	884.4	111.2	161.6
TM3-2014	1,366.8	889.6	28.8	908.7	337.1	1.4
TM4-2014	2,054.7	1,332.5	46.5	1,020.6	259.7	68.8
TM1-2015	1,981.4	1,484.3	36.5	1,037.2	293.9	5.7
TM2-2015	1,984.1	1,465.3	60.2	932.2	98.8	209.7
TM3-2015	1,957.8	1,327.4	24.9	958.0	162.2	175.8
TM4-2015	2,317.8	1,701.7	20.1	1,044.5	129.4	161.3
TM1-2016	2,092.9	1,615.1	45.5	1,018.8	171.4	154.3
TM2-2016	2,007.9	1,657.8	86.9	822.7	24.9	492.3
TM3-2016	2,271.9	1,263.1	38.3	831.0	141.8	199.4
TM4-2016	2,428.1	1,712.8	63.8	922.8	120.7	218.2
TM1-2017	2,104.0	1,678.4	50.9	1,106.0	215.8	141.5
TM2-2017	1,952.4	1,599.1	75.4	943.3	78.5	459.7
TM3-2017	1,799.6	1,316.8	23.0	964.6	66.7	194.4
TM4-2017	1,718.8	1,131.6	30.9	1,094.0	380.9	90.0
TM1-2018	1,980.0	1,657.5	70.0	1,106.6	119.2	106.4
TM2-2018	1,636.1	1,402.5	118.1	855.6	23.0	344.2

2 Importi dhe eksporti i derivateve të naftës dhe thëngjillit

Tab 2a.³ Importi i enërgjentëve (në mijë kg) nga TM1 2012 – TM2 2018

Tremujori	Antracit, qymyrbiuminoz, qymyrë tjetër	Briket, Linjit	Torf-jo energjetikë	Koks, gjysem koks etj	Benzinë, Naftë, Mazut të ndryshëm Kerozina etj	Gaza dhe hidrokarbure të tjera gazta	Parafina	Koks Naftë, mbtje naftë etj.	Bitum dhe asfalt natyral	Mastikë
TM1 2012	22,340.2	22,989.4	525.8	177.3	84,437.6	7,473.3	11.3	7,276.7	83.6	88.6
TM2 2012	11,277.5	10,737.3	411.0	43.8	98,414.4	8,268.7	16.7	26,533.4	26.1	713.6
TM3 2012	16,731.5	7,838.0	382.5	186.3	126,748.7	8,931.5	43.6	31,917.5	1.2	540.9
TM4 2012	18,186.7	11,203.7	249.1	214.0	109,731.7	9,338.8	6.8	27,803.1	301.4	354.5
TM1 2013	3,312.4	477.9	554.3	0.3	85,469.4	7,171.4	12.5	13,859.0	0.0	102.7
TM2 2013	7,963.0	25.9	522.1	9.1	106,395.9	12,157.5	25.5	35,568.8	310.2	582.0
TM3 2013	6,449.4	1,203.9	287.1	48.5	123,664.9	7,453.4	14.8	43,019.2	255.0	333.5
TM4 2013	2,222.1	1,029.8	206.8	39.1	98,749.7	8,681.2	7.0	27,162.6	0.1	360.5
TM1 2014	1,843.6	51.4	730.8	14.5	85,154.5	6,618.4	13.5	22,276.2	47.6	178.0
TM2 2014	2,496.0	0.0	703.4	19.6	102,998.8	9,134.4	9.6	35,381.7	4,339.3	319.1
TM3 2014	5,741.5	322.2	189.6	10.0	128,802.4	9,354.1	9.5	40,687.3	2,346.6	498.4
TM4 2014	4,737.5	788.2	471.2	0.0	118,378.8	7,519.7	8.2	40,843.7	5,695.6	230.3
TM1 2015	1,694.0	124.4	556.6	0.0	94,631.9	8,013.9	25.1	26,456.3	32.2	174.8
TM2 2015	3,204.7	155.5	1,237.3	0.0	116,734.7	8,439.1	14.3	43,417.2	0.4	765.7
TM3 2015	2,399.6	746.9	404.6	0.6	148,177.3	9,800.0	1.6	45,505.7	0.3	744.1
TM4 2015	4,952.1	1,058.4	923.2	29.8	133,478.2	9,237.5	29.6	58,056.6	0.1	619.6
TM1 2016	1,347.7	193.0	1,175.3	33.1	102,885.2	8,442.3	12.5	23,207.7	0.0	188.6
TM2 2016	21.9	0.3	1,190.3	61.7	126,998.6	10,073.9	21.8	26,936.3	0.3	551.1
TM3 2016	32.2	352.2	394.7	20.0	154,529.5	6,971.8	3.6	30,021.8	0.3	577.0
TM4 2016	450.3	1,340.9	1,494.2	35.6	141,103.3	9,622.0	0.5	41,181.2	0.1	517.1
TM1 2017	1,065.2	271.8	1,167.3	24.2	113,561.9	7,073.3	9.2	22,385.8	0.0	263.5
TM2 2017	769.2	0.0	1,080.5	48.9	141,520.6	9,056.7	22.3	40,549.0	0.6	421.9
TM3 2017	675.4	3,410.8	411.1	58.6	169,109.0	8,209.1	0.6	48,794.0	1.1	566.4
TM4 2017	40.6	5,004.5	912.9	64.1	142,782.5	8,394.9	0.5	56,536.4	0.5	214.7
TM1 2018	853.5	7,258.6	1,402.7	24.0	119,252.3	6,621.3	11.1	13,351.7	0.3	135.1
TM2 2018	164.1	627.8	1,739.5	92.5	144,003.9	7,581.0	36.1	50,009.2	0.2	518.4

³ Vlerat më pakë se 1000 kg nuk janë të paraqitura në tab 2a Importi i naftës, derivateve të naftës dhe thëngjillit apo janë zero.

Tab 2b.⁴ Eksporti i enërgjentëve (në mijë kg) nga TM1 2012 – TM2 2018

Tremujori	Antracit, qymyrituminoz, qymyrë tjetër	Briket, Linjit	Torf-jo energjetikë	Benzinë, Naftë, Mazut te ndryshem Kerozina etj	Gaza dhe hidrokarbure të tjera gazta	Parafina	Koks Naftë, mbetje naftë etj.	Bitum dhe asfalt natyral	Mastikë
TM1 2012	0.0	0.0	0.0	1.6	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TM2 2012	0.0	0.0	0.0	1.6	0.0	0.0	161.8	235.2	142.8
TM3 2012	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	4,263.6	11,158.9	16.5
TM4 2012	0.0	22.4	0.0	0.0	0.0	0.0	129.1	15,183.8	44.6
TM1 2013	48.1	599.9	0.0	0.1	0.0	2.4	157.1	0.0	0.1
TM2 2013	71.2	6,715.2	0.0	1.3	0.1	0.0	144.3	707.7	3.7
TM3 2013	73.6	5,449.5	0.0	12.8	0.0	0.0	231.4	8,671.4	0.0
TM4 2013	0.0	904.1	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	13,495.1	0.0
TM1 2014	0.0	568.7	0.0	0.0	0.0	1.2	0.0	1,209.8	0.0
TM2 2014	162.5	4,436.6	0.0	0.3	0.0	0.0	0.0	2,412.9	0.0
TM3 2014	828.7	10,136.7	0.0	0.0	0.0	0.0	397.1	6,548.4	0.0
TM4 2014	0.0	8,458.1	0.0	0.0	0.0	2.8	1,623.7	12,467.6	2.3
TM1 2015	0.0	10,216.0	0.0	0.0	0.0	0.0	341.3	309.4	0.0
TM2 2015	0.0	14,549.6	0.0	12.2	0.0	0.0	2,222.4	7,456.8	0.0
TM3 2015	0.0	12,041.1	0.0	0.0	0.0	0.0	4,042.4	6,911.2	28.0
TM4 2015	0.1	7,936.2	0.0	0.0	0.0	0.0	1,394.0	0.0	0.0
TM1 2016	0.0	2,880.2	0.0	20.9	0.0	0.0	0.0	5,054.9	0.0
TM2 2016	0.0	3,390.3	0.0	0.0	0.0	0.0	292.0	30,371.2	0.0
TM3 2016	0.0	5,929.2	0.0	7.9	0.0	0.0	0.0	16,322.5	4.4
TM4 2015	0.0	6,048.4	0.0	21.3	0.0	0.0	1,476.6	1,313.3	5.8
TM1 2017	0.0	6,441.7	4.2	10.0	0.0	1.5	2,758.9	0.0	0.0
TM2 2017	1.0	3,408.8	0.0	24.4	0.0	0.0	1,584.5	13,522.7	0.1
TM3 2017	0.0	1,958.4	0.0	20.0	0.0	0.0	1,385.2	15,474.7	0.0
TM4 2017	0.0	2,450.8	0.0	28.0	0.0	0.0	3,254.0	2,474.9	0.0
TM1 2018	0.0	25.7	0.0	0.0	0.0	0.0	1,362.1	106.1	0.0
TM2 2018	0.0	857.4	0.0	54.0	0.0	0.0	2,627.2	2,417.5	1.9

⁴ Vlerat më pakë se 1000 kg nuk janë të paraqitura në tab 2b apo janë zero..

3 Konsumatorët final (të fundit)

Tab 3a. Konsumatorët final apo të fundit të shpërndarë në pesë kategori nga TM1 2012 –TM2 2018⁵


Tremujori	Amvisnia GWh	Konsumatorët 220-110 kV (GWh)	Komerical GWh	Industria GWh	Nd.publik& të tjera GWh	Mihjet GWh
TM1-2012	616.8	139.6	179.7	60.8	36.5	-
TM2-2012	482.1	101.7	157.7	58.6	30.2	-
TM3-2012	455.9	111.1	168.5	58.8	31.5	-
TM4-2012	529.1	120.7	171.0	62.8	38.4	-
TM1-2013	607.9	111.6	187.3	61.2	38.8	-
TM2-2013	483.5	124.8	159.4	56.2	33.9	-
TM3-2013	480.8	125.9	172.7	58.2	34.2	-
TM4-2013	557.9	125.0	183.2	63.9	39.5	-
TM1-2014	556.7	121.6	184.3	55.8	39.7	-
TM2-2014	485.4	141.6	171.1	54.7	31.7	-
TM3-2014	468.5	178.8	170.1	58.1	25.5	-
TM4-2014	552.1	180.9	192.1	61.1	34.4	-
TM1-2015	576.0	167.4	199.0	59.1	36.0	-
TM2-2015	491.7	170.1	182.5	57.5	30.3	-
TM3-2015	481.0	178.5	199.8	69.3	29.2	-
TM4-2015	565.0	155.7	211.0	76.8	36.0	-
TM1-2016	589.2	120.6	211.0	73.1	35.0	-
TM2-2016	504.4	35.2	188.4	71.0	31.7	-
TM3-2016	498.1	33.5	204.6	75.5	27.4	-
TM4-2016	617.8	117.1	231.9	90.0	34.3	-
TM1-2017	643.4	118.0	226.8	85.1	32.6	-
TM2-2017	516.2	124.9	192.6	82.9	26.7	-
TM3-2017	497.1	126.7	219.5	89.5	25.9	-
TM4-2017	625.6	105.3	232.9	98.0	32.2	-
TM1-2018	677.1	87.8	244.0	91.1	6.8	29.9
TM2-2018	524.0	36.8	203.9	86.2	4.7	24.2

⁵ Pas revidimit të të dhënave për vitin 2017 nga ana e KECSO-s, ka reflektim edhe në dhënat e ASK-ës për vitin 2017.

Tab 3b. Struktura e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas konsumit final nga TM1 2012–TM2 2018

Tremujori	Amvisnia	Konsumatorët 220-110 kV	Komercial	Industria	Nd.publik& të tjera	Mihjet GWh
TM1-2012	59.7	13.5	17.4	5.9	3.5	-
TM2-2012	58.1	12.2	19.0	7.1	3.6	-
TM3-2012	55.2	13.5	20.4	7.1	3.8	-
TM4-2012	57.4	13.1	18.5	6.8	4.2	-
TM1-2013	60.4	11.1	18.6	6.1	3.9	-
TM2-2013	56.4	14.5	18.6	6.5	3.9	-
TM3-2013	55.2	14.4	19.8	6.7	3.9	-
TM4-2013	57.6	12.9	18.9	6.6	4.1	-
TM1-2014	58.1	12.7	19.2	5.8	4.1	-
TM2-2014	54.9	16.0	19.3	6.2	3.6	-
TM3-2014	52.0	19.8	18.9	6.4	2.8	-
TM4-2014	54.1	17.7	18.8	6.0	3.4	-
TM1-2015	55.5	16.1	19.2	5.7	3.5	-
TM2-2015	52.7	18.2	19.6	6.2	3.2	-
TM3-2015	50.2	18.6	20.9	7.2	3.1	-
TM4-2015	54.1	14.9	20.2	7.4	3.5	-
TM1-2016	57.3	11.7	20.5	7.1	3.4	-
TM2-2016	60.7	4.2	22.7	8.6	3.8	-
TM3-2016	59.4	4.0	24.4	9.0	3.3	-
TM4-2016	56.6	10.7	21.3	8.2	3.1	-
TM1-2017	58.2	10.7	20.5	7.7	2.9	-
TM2-2017	54.7	13.2	20.4	8.8	2.8	-
TM3-2017	51.9	13.2	22.9	9.3	2.7	-
TM4-2017	57.2	9.6	21.3	9.0	2.9	-
TM1-2018	59.6	7.7	21.5	8.0	0.6	2.6
TM2-2018	59.6	4.2	23.2	9.8	0.5	2.7

Graf 1. Struktura dhe shpërndarja e energjisë elektrike sipas konsumatorëve final TM2 2018



Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse; (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Të punësuar janë gjithsej 147 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 73,5% me shkollim universitar, 13,6 me shkollim të lartë, ndërsa 12,9% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>